

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË



ÇFARË PËRFAQËSON?

Gjykata e e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë fillon rregullisht ushtrimin e veprimtarisë gjyqësore e administrative më datë 01.05.2023.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, ndërpret veprimtarinë në datë 30.04.2023.

CILAT JANË KOMPETENCAT?

- Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ushtron veprimtarinë gjyqësore e administrative me seli në qytetin e Tiranës dhe kompetencë tokësore në bashkitë Tiranë, Kamzë, Vorë dhe Krujë.

Çfarë janë Zyrat e Shërbimit?

Zyra e Shërbimeve Krujë ngrihet dhe funksionon pranë godinës së ish-Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë e riorganizuar, për të ofruar shërbime administrative që lidhen me protokollin dhe arkivin gjyqësor.

CILAT JANË ORGANET E ADMINISTRIMIT GJYQËSOR?

- Këshilli i Gjykatës
- Kryetari/
Zëvendëskryetari
- Kancelar

TRANSFERIMI DHE MENAXHIMI I ÇËSHTJEVE GJYQËSORE NË GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË

ÇËSHTJET GJYQËSORE QË TRANSFEROHEN NË GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË

Çështjet gjyqësore të regjistruara në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Tiranë dhe Krujë deri në datën 30.04.2023, por që nuk kanë përfunduar sipas ligjit, transferohen në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

ÇËSHTJET GJYQËSORE NUK RINDAHEN ME SHORT

Çështjet gjyqësore të transferuara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nuk i nënshtrohen rindarjes me short elektronik, në përputhje me kriteret e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Këto çështje vijojnë të shqyrtohen nga i njëjti trup gjykues.

Kontakte:

Adresa e Gjykatës:

Bulevardi "Gjergj Fishta"

Email: infocivile@gjykatatirana.gov.al
Email: infopenale@gjykatatirana.gov.al
Tel: 045620107
Tel: 045620109